



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 04.04.2023

Nr: 46

Ora: 14:20

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 44, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN  
31.03.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.04.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari z. Zef Bushati

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 12, datë 28.03.2023, të KZAZ-së nr. 6, Bashkia Vau i Dejës, Shkodër

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21/c, 123/1, 126, 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 17 dhe 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 44 regj., datë 31.03.2023.

Në mbledhjen e datës 04.04.2023, ora 13 :40, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 44 nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, duke i lënë afat ankuesit të plotësojë të metat e kërkesës ankimore.

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, pasi plotësoi të metat e kërkesës ankimore nr. 44, ka ridepozituar kërkesën ankimore nr. 44, me datë 04.04.2023.

Në mbledhjen e datës 04.04.2023, ora 14:20, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 44 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

## **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 44, datë 31.03.2023 të paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari z. Zef Bushati.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 04.04.2023, ora 14:40.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

**Elvin LAKO** - **Relator**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**